



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



ZYRA PËR REGJISTRIMIN, CERTIFIKIMIN DHE KONTROLLIN FINANCIAR TË  
SUBJEKTEVE POLITIKE (Zyra) NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE  
(KQZ) sipas autorizimeve të dhëna me paragrafin 1 të nenit 21 dhe në përputhje me nënparagrafin  
8, paragrafi 6 i nenit 21 i Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike (LFSP), me datën 11.07.2024,  
merr këtë:

**VENDIM**

**Për shqiptimin e gjobës për subjektin politik të regjistruar ORGANIZATA BALLI  
KOMBËTAR DEMOKRAT**

- I. Subjektit politik ORGANIZATA BALLI KOMBËTAR DEMOKRAT, i shqiptohet gjoba në vlerë katër mijë (4,000) euro për shkeljen sipas nënparagrafit 8, paragrafi 6 i nenit 21 të LFSP.
- II. Subjekti politik ORGANIZATA BALLI KOMBËTAR DEMOKRAT, obligohet që brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të këtij vendimi, të paguaj shumën e gjobës së shqiptuar sipas pikës I të këtij vendimi dhe të dorëzojë në Zyrës një kopje të fletëpagesës së gjobës së paguar.
- III. Me kalimin e afatit të përcaktuar në pikën II të këtij vendimi, gjobat ekzekutohen në mënyrë të detyrueshme nga Përmbartuesi Privat.
- IV. Vendimet e Zyrës për shqiptimin e gjobave hyjnë në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme.

**Arsyetim**

Subjekti politik ORGANIZATA BALLI KOMBËTAR DEMOKRAT, është subjekt politik i regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi, nga data 21.12.2015.

Pas dorëzimit të raportit vjetor financiar nga subjekti politik, Zyra ka vërejtur se subjekti politik ka pranuar kontribute në kundërshtim me paragrafin 6 të nenit 4 të LFSP. Në përputhje me paragrafin 5 të nenit 4 të LFSP që thekson se, nëse një subjekt politik ka pranuar mjete financiare në kundërshtim me dispozitat e LFSP, subjekti politik obligohet që brenda dy (2) javësh nga data e pranimit të këtyre mjeteve, t'i kthejë ato përmes llogarisë bankare në burmimin e pranimit dhe brenda të njëjtit afat të njoftojë KQZ.

Zyra me datën 12.03.2024 ka dërguar kërkesë te subjekti politik ORGANIZATA BALLI KOMBËTAR DEMOKRAT, që mban numrin e protokollit 173/12.03.2024 përmes së cilës ka

kërkuar nga subjekti politik, që mjetet financiare të pranuar përmes arkës (para të gatshme) në vlerën totale 500 euro, t'i kthejë përmes transaksionit bankar, me ç' rast, subjekti politik nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në kthimin e këtyre mjeteve, siç është kërkuar përmes kërkesës, dhe gjetja është konstatuar edhe nga auditori ligjor, e cila është prezantuar në raportin përfundimtar të auditimit.

Subjekti politik ORGANIZATA BALLI KOMBËTAR DEMOKRAT, obligohet që pagesën ta kryejë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit për shqiptimin e gjobës përmes komunikimit zyrtar elektronik. Pagesa e gjobës duhet të dëshmohet përmes dorëzimit të kopjes së fletëpagesës në Zyrë. Në rast të dështimit të pagesës së gjobës brenda afatit të dhënë si në pikën II të këtij vendimi, gjoba e shqiptuar ndaj subjektit politik do të ekzekutohen në mënyrë të detyrueshme nga Përmbaruesi Privat.

**Nga sa u tha më lartë, Zyra vendosi për shqiptimin e gjobës në vlerë prej katër mijë (4,000) euro, sipas dispozitivit të këtij vendimi.**

**Prishtinë, 11.07.2024**

**Drejtori i Zyrës**



**Besnik Buzhala**

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të subjektit politik ORGANIZATA BALLI KOMBËTAR DEMOKRAT
- Përfaqësuesit të autorizuar financiar të subjektit politik ORGANIZATA BALLI KOMBËTAR DEMOKRAT.

**Këshilla juridike:** Subjekti politik mund të inicojë padi kundër vendimit të Zyrës për shqiptimin e gjobave, pranë gjykatës kompetente të shkallës së parë, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, pas njoftimit për vendimin. Inicimi i padisë nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.